

**URDHËR**  
**Nr. 197, datë 22.6.2022**

**PËR DELEGIM TË PËRKOHSHËM TË KOMPETENCAVE**

Në zbatim të nenit 28 dhe 29, të Kodit të Procedurave Administrative, të VKM-së nr. 58, datë 29.1.2004, “Për organizimin e Drejtorisë së Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar”; të nenit 26, të rregullores së brendshme të Drejtorisë së Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar, miratuar me urdhrin e Kryeministrit nr. 1, datë 14.1.2015, “Për miratimin e rregullores së brendshme të Drejtorisë së Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (DSIK)”, të ndryshuar,

**URDHËROJ:**

1. Delegimin e përkohshëm të kompetencave të mëposhtme të titullarit të Drejtorisë së Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar, me përjashtim të kompetencave të cilat nuk delegohen dhe që janë të shprehura me ligj, drejtorit të Drejtorisë së Sigurimit të Sistemeve të Komunikimit dhe Informacionit, z. Enton Sadiku.

2. Z. Enton Sadiku i delegohen kompetencat si më poshtë:

- ndjek dhe zbaton “Rregulloren për funksionimin dhe organizimin e Drejtorisë së Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar” (e ndryshuar);
- ndjek dhe monitoron prezencën në punë të personelit të DSIK-së;
- ndjek detyrat e vendosura në planin mujor;
- merr dhe trajton korrespondencën shkresore.

3. Kompetencat e mësipërme delegohen për periudhën nga data 27.6.2022 deri 1.7.2022.

4. Z. Enton Sadiku nuk mund t’i nëndelegojë këto kompetenca.

5. Për ndjekjen e këtij urdhri ngarkohet drejtori i Drejtorisë së Sigurimit të Sistemeve të Komunikimit dhe Informacionit.

6. Me njohjen dhe zbatimin e këtij urdhri ngarkohen të gjithë nëpunësit/punonjësit e Drejtorisë së Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar.

7. Ky urdhër hartohet në 3 (tre) kopje të njëjta, një për Protokoll/Arkivin, një për drejtorin e Drejtorisë së Sigurimit të Sistemeve të Komunikimit dhe Informacionit dhe një për QBZ-në.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

**DREJTOR I PËRGJITHSHËM**  
**Dorian Tola**